



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANE SH.A.
DREJTORIA E PROKURIMEVE
SEKTORI I SHËRBIMEVE DHE MALLRAVE

Nr. _____ Prot.

Tiranë , më ____/____/2020

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Inpress ”sh.p.k

Adresa: : Tiranë, Ish Blloku i Magazinave të Tregtisë, Rruga Siri Kodra 5,

Procedura e prokurimit: **“Kërkesë për propozim/mallra**

Numri i referencës së procedurës: **REF-46834-12-26-2019**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **” Blerje libreza dhe kontrata”**

Fond limit 2,000,000 (dy milion) lekë pa TVSH.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet):

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. “Albdesign P.S.P” sh.p.k”

L51819005Q

Vlera 1,980.000 (një milionë e nëntëqind e tetëdhjetë mijë) lekë pa tvsh.

2. “ Inpress”sh.p.k

L52122014L

Vlera 1,440,000 (një milion e katërqind e dyzetë mijë) lekë pa tvsh.

3. “Kristalina.KH” sh.p.k

K11501002D

Vlera 1,780,000 (një milionë e shtatëqind e tetëdhjetë mijë) lekë pa tvsh.

4.”Shtëpia Botuese Shtypshkronja Morava”sh.p.k

J82019001J

Vlera 1,700,000 (një milionë e shtatëqind mijë) lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

Vlera 1,440,000 (një milion e katërqind e dyzetë mijë) lekë pa tvsh

Pwrkatwsisht pwr arsyet e mwposhtme:

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar) Neni 56 dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar Kreu VII, Neni 66, pika 5, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave referuar formulës së përcaktuar në dokumentat e tenderit verifikoi nëse oferta e vlefshme janë me çmim Anomalisht të Ulët nga ku rezultoi se oferta e paraqitur nga operatori ekonomik "Inpress" sh.p.k është në kushtet e Ofertës Anomalisht të Ulët.

Në këto kushte në zbatim të nenit 56 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar shprehimisht citohet se

1) Kur AK vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta ai përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elementet e veçantë të ofertës për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

Në zbatim të nenit 56 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar KVO-ja më datë 14.02.2020 i dërgoi shkresë operatorit ekonomik "Inpress" sh.p.k me qëllim depozitimin e dokumentacionit provues dhe argumentimin me shkrim të ofertës anomalisht të ulët pranë AK brenda 3 ditëve punë.

Më datë 20.02.2020 prot hyrës 4077 pranë Autoritetit Kontraktor UKT sh.a është protokolluar shkresa e operatorit ekonomik Inpress sh.p.k me lëndë "Informacion sqarues" drejtuar Ujësjellës Kanalizime Tiranë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se shkresa e depozituar nga operatori ekonomik "Inpress" sh.p.k pranë AK është paraqitur jashtë afatit të parashikuar në dispozitat ligjore.

Bëjmë me dije se në mbështetje të dispozitave ligjore të mësipërme si dhe shkresës së dërguar nga AK operatori ekonomik pjesëmarrës ka qënë i detyruar të zbatojë afatin e përcaktuar sipas nenit 56 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, pra, duke paraqitur sqarimin mbi ofertën anomalisht të ulët brenda 3 ditëve punë pranë AK.

Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, KVO gjykon se operatori ekonomik ka

dështuar në dorëzimin e dokumentacionit me shkrim pranë AK brenda 3 ditëve punë për shkak se shkresa e dorëzuar nga operatori ekonomik pranë AK është dorëzuar më datë 20.02.2020, prot hyrës 4277.

Përsa më sipër, theksojmë se barra e provës mbi argumentimin e ofertës anomalisht të ulët dhe **paraqitjen e dokumentacionit me shkrim** brenda afatit ligjor të parashikuar nga LPP pranë Autoritetit Kontraktor iu përket operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.

Theksojmë se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (**ndër to dhe ai i depozitimit të sqarimit të ofertës anomalisht të ulët dhe dokumentacionit provues pranë AK brenda 3 ditëve pune**), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës.

Referuar rastit konkret sqarojmë se për faj të vetë operatorit pjesëmarrës nuk është depozituar dokumentacioni provues me shkrim pranë AK sipas afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” neni 56.

Rrjedhimisht Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se nga ana e operatorit ekonomik nuk është sjellë argumentimi i ofertës anomalisht të ulët dhe depozitimi i dokumentacionit pranë AK në respektim të afatit të përcaktuar në dispozitat ligjore të nenit 56 të LPP-së ndaj dokumentacioni i paraqitur më datë 20.02.2020 nga ky operator nuk do të merret në shqyrtim nga KVO.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “Inpress sh.p.k” me ofertë 1,440,000 (një milion e katërqind e dyzetë mijë) lekë pa tvsh se është identifikuar ofertë e vlefshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë UKT sh.a sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të vijohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **21.02.2020**

Ankesa: PO(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë 27.02.2020

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 pika 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, UKT sh.a është paraqitur Formulari i Ankesës nga Operatori Ekonomikë “Inpress” Sh.p.k hyrë në UKT sh.a me shkresën Nr.K 715 Prot. datë 26.02.2020. (administruar në dosjen e prokurimit) në lidhje me vlerësimin për procedurën e prokurimit me objekt: ” Blerje librezë dhe kontrata”

Me marrjen e ankesës nga Operatori Ekonomik i mësipërm, në mbështetje të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), Neni 63, pika 3 si dhe në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" (i ndryshuar), me Urdhërin me Nr. 29603/13 Prot. dt. 26.02.2020 Prot., është pezulluar procedura e prokurimit deri në marrjen e një vendimi përfundimtar sipas rregullave të parashikuara nga LPP dhe RRPP. Gjithashtu në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 6, gërma "a" të VKM-së Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" me Urdhërin me Nr. 29603/14 Prot. dt. 26.02.2020 u ngrit Grupi i Shqyrtimit të Ankesave.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi ka shqyrtuar ankesën e OE "Inpress" Sh.p.k", ka konkluduar sa më poshtë:

Nuk janë marrë parasysh pretendimet e ngritura nga Operatori Ekonomik të mësipërm dhe është konsideruar i drejtë dhe i bazuar në ligj, Vendimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Ky konkluzion i është rekomanduar Titullarit të Autoritetit Kontraktor si dhe është vënë në dijeni Operatori Ekonomik "Inpress" Sh.p. " shpk me ane të shkresës Nr. K-715/1 datë 27.02.2020 (administruar në dosjen e prokurimit).

Gjatë ezuarimit të afateve të ankimimit operatori ekonomik ka ushtruar të drejtën e ankimimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Në datë 06.04.2020 pranë UKT sh.a protokoll hyrës nr. 931 është depozituar vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik i cili ka vendosur përsëritjen e kërkesës për sqarim oferte anomalisht të ulët për procedurën me objekt "Blerje libreza dhe Kontrata" drejtuar operatorit ekonomik Inpress sh.p.k.

Në zbatim të vendimit të KPP-së më datë 07.04.2020 Autoriteti Kontraktor UKT sh.a dërgoi shkresë operatorit ekonomik "Inpress" sh.p.k kërkesën për sqarim oferte anomalisht të ulët në zbatim të nenit 56 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar.

Më datë 17.04.2020 prot hyrës nr. K-1008 operatori ekonomik depozitoi shkresën me lëndë "Kthim Përgjigje shkresës nr. prot për sqarim oferte anomalisht të ulët"

Komisioni i Vlerësimit të ofertave pasi mori në shqyrtim materialin e depozituar nga ana e operatorit ekonomik konstatoi se dokumentacioni i dorëzuar është konform nenit 56 të LPP-së.